



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KPM- 2017/02

Në mbështetje të nenit 3, paragrafi 2, pika 6 dhe 11, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM miraton:

RREGULLORE PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE

NENI 1 QËLLIMI

Kjo Rregullore përcakton kriteret, të drejtat dhe obligimet për ofruesit e shërbimeve mediale, pa marrë parasysh mënyrën e transmetimit në Republikën e Kosovës, me qëllim të garantimit të mbrojtjes së pluralizmit medial dhe interesit publik, si dhe të mundësohet garë e drejtë dhe e barabartë në tregun medial në Republikën e Kosovës.

NENI 2 FUSHËVEPRIMI

Kjo Rregullore do të zbatohet ndaj të gjithë ofruesve të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale që janë themeluar ligjërisht në territorin e Republikës së Kosovës, për të ofruar shërbime mediale audio dhe audiovizuale në brezin për transmetim tokësor si dhe përmes formave tjera të komunikimeve elektronike jashtë brezit radiodifuziv.

NENI 3 PËRKUFIZIMET

1. **Shërbimi medial audiovizual (SHMAV)** - shërbimi i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i së cilës është ofrimi i programeve, me qëllim që të informojnë, argëtojnë apo të edukojnë gjithë publikun përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike.

2. **Shërbimi medial audio (SHMA)** – shërbim i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimit medial audio dhe parimi kryesor i të cilit është ofrimi i programeve, me qëllim që të informojë, argëtojë apo edukojë gjithë publikun, përmes rrjetave të komunikimeve elektronike. Shërbimi medial audio është një radio transmetim, një shërbim medial audio me kërkesë apo komunikim komercial në shërbimet mediale audio.
3. **Ofrues i shërbimit medial (OSHM)** –personi fizik ose juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuale të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.
4. **Operatori i shpërndarjes** – personi juridik i cili shpërndanë shërbime mediale audiovizuale për përdoruesit përmes rrjetit kabllor, IPTV dhe çfarëdo forme tjetër të shpërndarjes jashtë brezit frekuencor radio-difuziv.
5. **Operatori i multipleksit** - personi juridik që ofron infrastrukturën teknike për shpërndarjen tokësore të programeve dixhitale dhe shërbimet suplementare për transmetimin dixhital të të dhënave.
6. **Multipleksi** – (në tekstin e mëtejme “MUX”) një set i standardizuar i sinjaleve dixhitale, i shprehur në Mbit/s (Mega-bit-për-sekondë), që përmban disa programe televizive dhe/ose të radios dhe/ose të dhëna të tjera, të cilat transmetohen dhe emetohen në të njëjtën kohë dhe në mënyrë të thurur.
7. **Video on demand (“Video sipas kërkesës”)** - shërbimet e mediave jolineare audiovizuale - shërbimi medial audiovizual që sigurohet nga ofruesi i shërbimit medial për programet pamore në çastin e caktuar nga përdoruesi dhe kërkesa e individit e bazuar në katalogun e programeve të zgjedhura nga ofruesi medial i shërbimeve.
8. **Shpërndarje** – ofrimi i shërbimeve mediale audiovizuale përmes operatorëve të cilët pavarësisht teknologjisë së përdorur (me apo pa tel) shpërndajnë përmbajtje audiovizuale deri te përdoruesit.
9. **Program** - një pako e fotografive lëvizëse me ose pa zë që përbën një njësi të vetme brenda orarit ose katalogjeve të programeve të vendosura nga ofruesi i shërbimit medial, forma e të cilit është e krahasueshme me formën dhe përmbajtjen e transmetimit televiziv. Shembujt e programeve përfshijnë filmat e metrazhit të gjatë, ngjarjet sportive, komeditë, dokumentarët, programet për fëmijë dhe dramat origjinale.
10. **Parashtruesi i kërkesës** – çdo subjekt që bën kërkesë për licencë të KPM-së ose që kërkon miratim për transferimin e një licence ekzistuese ose miratimin për marrjen e një pjese të pronësisë tek një i Licencuar ekzistues.
11. **Personi i autorizuar** - një individ që përfaqëson dhe zbaton udhëzimet e një pale të tretë, por jo edhe në emër të një organizate politike ose të një bashkësie fetare.

12. **Licencë** – leja e dhënë nga KPM-ja për ofruesit e shërbimeve mediale për të ushtruar aktivitet të ofrimit të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.
13. **I Licencuar** - personi juridik të cilit KPM-ja i ka dhënë Licencën për të ofruar shërbime mediale audio dhe audiovizuale.
14. **Përgjegjësia redaktuese** – ushtrimi i kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen e programeve dhe mjeteve për ushtrimin e kontrollit efektiv mbi përzgjedhjen dhe organizimin e tyre në radhitje kronologjike në rastin e transmetimit televiziv, ose në katalog në rastin e shërbimit medial audiovizual në bazë të kërkesës.
15. **Transmetim** - emetimi burimor i programit me valë difuzive nëpërmjet transmetuesit tokësor, rrjetit kabllor, transmetimit dixhital, satelitor ose me pajisje të tjera elektronike, të koduar apo të pakoduar, që i destinohen për shfrytëzim publikut që pranohen me radio, televizion ose pajisje elektronike të veçanta për emetim, duke mos përfshirë komunikimet individuale.
16. **Transmetuesi Publik** - Radio Televizioni i Kosovës.
17. **TV me Pagesë (Pay TV)** – një sistem i transmetimit përmes të cilit programet televizive transmetohen në formë të mbyllur (koduar) dhe është i qasshëm vetëm për përdoruesit të cilët paguajnë abonim për qasje në përmbajtje dhe për pajisjet dekoduese.
18. **TV me transmetim të hapur (Free-to-air)** - një sistem transmetim me qasje të hapur, për të cilin nuk kërkohet ndonjë abonim nga ana e përdoruesve.
19. **Produksion i pavarur** - çdo subjekt i regjistruar biznesor, që ka statusin e personit juridik dhe i cili në pajtim me ligjin realizon projekte dhe vepra përkatëse audiovizuale në interes të publikut.
20. **Kanal gjeneralistik** – ofruesi i shërbimit medial që ofron një gamë të gjerë të programeve dhe llojeve të programeve për publikun e ndryshëm.
21. **Kanal tematik**- ofruesi i shërbimit medial, programi i të cilit përmban 70% të një lloji të caktuar programor si: informativ, edukativ, argëtues, për fëmijë, sportiv, shkencor etj.
22. **Segment Programor** – programi në tërësinë e tij, qartë i dalluar prej segmenteve tjera me fillimin dhe fundin e tij.
23. **Strukturë programore** – të gjitha segmentet programore të ofruara nga një ofrues i caktuar i shërbimeve mediale audiovizuale.
24. **Program vetanak** – nënkupton segmentet programore që përbëhen nga produksione vetanake të ofruesit të shërbimit medial audiovizual, të bashkëprodhuara dhe të blera.

25. **Produksioni vetanak** - segmentet programore të prodhuara në tërësi nga vetë shërbimet audiovizuale, duke përdorur burimet vetanake njerëzore dhe materiale apo segmentet programore të prodhuara nga ndonjë kompani tjetër për qëllimet e shërbimeve audio-vizuale, sipas kërkesës dhe me shpenzime të ofruesit të shërbimit medial audiovizual.
26. **Bashkëprodhim** - segmentet programore në prodhimin e të cilit ofruesi i shërbimit medial audiovizual ka marrë pjesë me mjetet e tij materiale dhe/apo burime njerëzore.
27. **Program i blerë** - segmentet programore për transmetimin e të cilit ofruesi i shërbimit medial audiovizual ka siguruar të drejtat.
28. **Program i ritransmetuar** – programi i transmetuar nga një ofrues i shërbimit medial audiovizual që merret tërësisht nga një ofrues tjetër i shërbimit medial audiovizual me qëllim të transmetimit të njëkohshëm.
29. **Programi i shkëmbyer** - pjesë të programit të shkëmbyer në mes të dy apo më shumë ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale.
30. **Skema programore** - një skemë e detajuar për çdo orë të transmetimit të programit të ofruesit të shërbimit medial audiovizual.
31. **Vlefshmëria e Licencës** – afati i kohëzgjatjes së licencës së lëshuar nga KPM nga data e marrjes së vendimit deri në datën e skadimit.

KREU I

LICENCIMI I OFRUESIT TË SHËRBIMIT MEDIAL AUDIO ME TRANSMETIM TOKËSOR

NENI 4

PARASHTRIMI I KËRKESËS PËR LICENCË

Kërkesa për licencë të KPM-së për Ofrues të Shërbimit Medial Audio (me transmetim tokësor (në brezin radio-difuziv) bëhet në pajtim me Nenin 21, 22 dhe 23 të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave (Ligji Nr. 04/L-44). Kërkesat për licencim për transmetim përmes rrjetit tokësor do të pranohen vetëm në bazë të shpalljes së konkursit nga KPM.

NENI 5

KRITERET KUALIFIKUESE DHE PROFESIONALE

1. Parashtruesi i kërkesës duhet të ofrojë dëshmi dhe të garantojë me shkrim që i përmbahet kushteve si në vijim:

1.1 Prezencë të ligjshme në Kosovë: Kompania private ose organizata joqeveritare duhet të jenë fizikisht të pranishme në Republikën e Kosovës dhe të jenë të regjistruar në përputhje me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.

1.2 Përfaqësuesi i kompanisë ose organizatës joqeveritare duhet që me rastin e aplikimit për licencë të ofrojë dëshmi se është shtetas i Republikës së Kosovës.

2. I Licencuari mund të jetë:

2.1. Kompani private e regjistruar ligjërisht në Republikën e Kosovës, ku përfshihen por nuk kufizohet vetëm në to, ndërmarrje e biznesit privat, ortakëri e zakonshme, ortakëri e kufizuar, ndërmarrje aksionare ose me përgjegjësi të kufizuar që ka të regjistruar ushtrimin e veprimtarisë së transmetimit të programeve përmes shërbimeve audio.

2.2. Organizatë Jo-Qeveritare (OJQ) e regjistruar në bazë të ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, në veprimtaritë e së cilës përfshihet edhe transmetimi i radio programeve.

3. Parashtruesi i kërkesës për Licencë duhet të dëshmojë angazhim dhe aftësi për të vënë në funksion një ofrues të shërbimit medial audio në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.

4. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë angazhim dhe aftësi për të siguruar programe komerciale në mënyrë ligjore.

5. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se posedon një staf me kualifikime superiore (universitare) për çështjet programore dhe teknike.

6. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se ka kryer të gjitha obligimet lidhur me taksën dhe tatimet në pajtim me legjislacionin e Administratës Tatimore të Kosovës.

7. Parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë dëshmi nga Gjykata Ekonomike që nuk ka kontest gjyqësor.

NENI 6 KRITERET PROGRAMORE

1. Kriteret programore për ofruesin e shërbimit medial audio përfshijnë:

1.1 Pajtueshmërinë e skemës programore javore, përfshirë segmentet dhe strukturën programore, me aktet nënligjore të KPM-së;

1.2 Nivelin e përgjithshëm të aftësive dhe përvojës së stafit përgjegjës për çështje programore, vlerësuar në bazë të strukturës organizative, arsimimit dhe përvojës së

punës; dhe

1.3 Specifikat e përmbajtjes programore në një zonë gjeografike të caktuar të vlerësuar me shkallën në bazë të të cilës skema e planifikuar programore, së bashku me segmentet dhe strukturën programore, është paraqitur në atë zonë të caktuar gjeografike.

NENI 7 KRITERET EKONOMIKE

Kriteret ekonomike për ofruesin e shërbimit medial audio përfshijnë:

1. Qëndrueshmërinë ekonomike të parashtruesit të kërkesës për sa i përket sasisë së kapitalit të përbashkët të regjistruar.
2. Performancën ekonomike të parashtruesit të kërkesës për sa i përket strukturës dhe burimeve të financimit, përfshirë masat e likuiditetit, aftësinë paguese dhe borxhit.
3. Plani i biznesit për tri vitet e ardhshme, përfshirë strukturën organizative dhe numrin e përgjithshëm të të punësuarve.

NENI 8 KRITERET TEKNIKE

Kriteret teknike për të ofruar shërbim medial audio me transmetim cilësor përfshijnë:

1. Sistemin e transmetimit në pajtim me projektin teknik;
2. Cilësinë e teknologjisë së propozuar për transmetim;
3. Cilësinë e teknologjisë dhe pajtueshmërinë me standardet e propozuara të punës në studio.

NENI 9 DHËNIA E LICENCËS

1. Licenca për ofrues të shërbimit medial audio me transmetim tokësor jepet ekskluzivisht vetëm përmes konkursit publik.
2. Licenca për ofrues të shërbimit medial audio përmes shërbimeve të transmetimit tokësor do të lëshohet pas kompletimit të procedurës së tenderit publik.
3. Struktura programore dhe parametrat teknike do të jenë pjesë përbërëse e licencës për ofrues të shërbimit medial audio me transmetim tokësor si shtojcë e licencës.

KREU II
LICENCIMI I OFRUESIT TË SHËRBIMIT MEDIAL AUDIOVIZUAL
ME TRANSMETIM TOKËSOR PËRMES OPERATORIT TË
MULTIPLEKSIT

NENI 10
PARASHTRIMI I KËRKESËS

Kërkesa për licencë të KPM-së për Ofrues të Shërbimit Medial Audiovizual me transmetim tokësor, transmetim të hapur (free-to-air) dhe transmetim me pagesë, përmes operatorit të multipleksit do të pranohet vetëm në bazë të shpalljes së konkursit publik nga KPM.

NENI 11
KRITERET KUALIFIKUESE DHE PROFESIONALE

1. Parashtruesi i kërkesës duhet të ofrojë dëshmi dhe të garantojë me shkrim që i përmbahet kushteve si në vijim:
 - 1.1 Prezencë të ligjshme në Kosovë: Kompania private ose organizata joqeveritare duhet të jenë fizikisht të pranishme në Republikën e Kosovës dhe të jenë të regjistruar në përputhje me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.
 - 1.2 Përfaqësuesi i kompanisë ose organizatës joqeveritare duhet që me rastin e aplikimit për licencë të ofrojë dëshmi se është shtetas i Republikës së Kosovës.
2. I Licencuari mund të jetë:
 - 2.1 Kompani private e regjistruar ligjërisht në Republikën e Kosovës, ku përfshihen por nuk kufizohet vetëm në to, ndërmarrje e biznesit privat, ortakëri e zakonshme, ortakëri e kufizuar, ndërmarrje aksionare ose me përgjegjësi të kufizuar që ka të regjistruar ushtrimin e veprimtarisë së transmetimit të programeve përmes shërbimeve audiovizuale;
 - 2.2 Organizatë Jo-Qeveritare (OJQ) e regjistruar në bazë të ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, në veprimtaritë e së cilës përfshihet edhe transmetimi i TV programeve .
3. Parashtruesi i kërkesës për Licencë duhet të dëshmojë angazhim dhe aftësi për të vënë në funksion një ofrues të shërbimit medial audiovizual në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
4. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë angazhim dhe aftësi për të siguruar programe komerciale në mënyrë ligjore.

5. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se posedon një staf me kualifikime superiore (universitare) për çështjet programore dhe teknike.
6. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se ka kryer të gjitha obligimet lidhur me taksën dhe tatimet në pajtim me legjislacionin e Administratës Tatimore të Kosovës.
7. Parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë dëshmi nga Gjykata Ekonomike që nuk ka kontest gjyqësor.

NENI 12

KRITERET PROGRAMORE

1. Kriteret e përgjithshme programore për ofruesin e shërbimit medial audiovizual me transmetim tokësor përmes operatorit të multipleksit përfshijnë:

- 1.1. Pajtueshmërinë e skemës programore javore, përfshirë segmentet dhe strukturën programore, me aktet nënligjore të KPM-së;
- 1.2. Nivelin e përgjithshëm të aftësive dhe përvojës së stafit përgjegjës për çështje programore, vlerësuar në bazë të strukturës organizative, arsimimit dhe përvojës së punës; dhe
- 1.3. Specifikat e përmbajtjes programore në një zonë gjeografike të caktuar të vlerësuar me shkallën në bazë të të cilës skema e planifikuar programore, së bashku me segmentet dhe strukturën programore, është paraqitur në atë zonë të caktuar gjeografike.

2. Kriteret specifike programore për ofruesin e shërbimit medial audiovizual me transmetim tokësor përmes operatorit të multipleksit:

- 2.1. Programi me karakter gjeneralistik që ofron strukturë dhe segmente programore si në vijim:
 - 2.1.1. Programme informative përmes së cilave qytetari i Republikës së Kosovës realizon të drejtën për informim pa dallim etnie, gjinie, besimi fetar apo bindjeje politike;
 - 2.1.2. Programme të cilat promovojnë të drejtat njerëzore, me qëllim të zhvillimit të një shoqërie të lirë e demokratike;
 - 2.1.3. Programme edukative, arsimore, kulturore dhe zbavitëse, të dedikuara për fëmijë dhe të rritur;
 - 2.1.4. Programme për personat me nevoja të veçanta;

- 2.1.5. Programe që promovojnë identitetin kulturor dhe trashëgiminë kulturore të Kosovës;
- 2.1.6. Programe që afirmojnë dhe mbështesin zhvillimet kulturore dhe krijimtarinë artistike në Republikën e Kosovës;
- 2.1.7. Programe që promovojnë kulturën e dialogut publik;
- 2.1.8. Programe të dedikuara për mbrojtjen e ambientit; dhe
- 2.1.9. Programe që promovojnë edukimin akademik, promovimin akademik të fjalës së shkruar, kulturës gjuhësore si dhe ligjërimin e rrjedhshëm.
- 2.1.10. Mundësitë teknike për të ofruar qasje në programet e tyre për personat me aftësi të kufizuara (sinkronizimi dhe titrimi si dhe gjuha e shenjave)
- 2.1.11. Mundësitë teknike që të ofrojnë segmente të programit të tyre në gjuhët zyrtare të Kosovës (dokumentarë, programe edukative dhe shkencore, programe informative, filma.)

NENI 13 KRITERET EKONOMIKE

Kriteret ekonomike për ofruesin e shërbimit medial audiovizual përfshijnë:

1. Qëndrueshmërinë ekonomike të parashtruesit të kërkesës për sa i përket sasisë së kapitalit të përbashkët të regjistruar.
2. Performancën ekonomike të parashtruesit të kërkesës për sa i përket strukturës dhe burimeve të financimit, përfshirë masat e likuiditetit, aftësinë paguese dhe borxhit.
3. Planin e biznesit për tri vitet e ardhshme, përfshirë strukturën organizative dhe numrin e përgjithshëm të të punësuarve.

NENI 14 DHËNIA E LICENCËS

1. Licenca për ofrues të shërbimit medial audiovizual me transmetim tokësor jepet ekskluzivisht vetëm përmes konkursit publik.
2. Licenca për ofrues të shërbimit medial audiovizual me përmes shërbimeve të transmetimit tokësor do të lëshohet pas kompletimit të procedurës së konkursit publik.

3. Segmentet dhe struktura programore do të jenë pjesë përbërëse e Licencës për transmetim tokësor si shtojcë e licencës.

KREU III

LICENCIMI I OFRUESIT TË SHËRBIMIT MEDIAL AUDIO DHE AUDIOVIZUAL PËRMES OPERATORËVE TË SHPËRNDARJES

NENI 15

PARASHTRIMI I KËRKESËS PËR LICENCË

1. Kërkesa për licencë të KPM-së për ofrues të shërbimit medial audio dhe audiovizual përmes operatorëve të shpërndarjes, jashtë brezit radio difuziv, mund të parashtrohet në çdo kohë dhe pa konkurs, sipas procedurave të përcaktuara nga KPM.
2. Parashtruesi i kërkesës duhet të tregojë se përmes cilit rrjet të komunikimit elektronik planifikon të shpërndajë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

NENI 16

KRITERET KUALIFIKUESE DHE PROFESIONALE

1. Parashtruesi i kërkesës duhet të ofrojë dëshmi dhe të garantojë me shkrim që i përmbahet kushteve si në vijim:
 - 1.1. Prezencë të ligjshme në Kosovë: Kompania private ose organizata joqeveritare duhet të jenë fizikisht të pranishme në Republikën e Kosovës dhe të jenë të regjistruar në përputhje me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës.
 - 1.2. Përfaqësuesi i kompanisë ose organizatës joqeveritare duhet që me rastin e aplikimit për licencë të ofrojë dëshmi se është shtetas i Republikës së Kosovës.
2. I Licencuari mund të jetë:
 - 2.1. Kompani private e regjistruar ligjërisht në Republikën e Kosovës, ku përfshihen por nuk kufizohet vetëm në to, ndërmarrje e biznesit privat, ortakëri e zakonshme, ortakëri e kufizuar, ndërmarrje aksionare ose me përgjegjësi të kufizuar që ka të regjistruar ushtrimin e veprimtarisë së transmetimit të programeve përmes shërbimeve audio apo audiovizuale;
 - 2.2. Organizatë Jo-Qeveritare (OJQ) e regjistruar në bazë të ligjit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës, në veprimtaritë e së cilës përfshihet edhe transmetimi i programeve radio apo TV.

3. Parashtruesi i kërkesës për Licencë duhet të dëshmojë angazhim dhe aftësi për të vënë në funksion një ofrues të shërbimit medial audio dhe audiovizual në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
4. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë angazhim dhe aftësi për të siguruar programe komerciale në mënyrë ligjore.
5. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se posedon një staf me kualifikime superiore (universitare) për çështjet programore dhe teknike.
6. Parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se ka kryer të gjitha obligimet lidhur me taksën dhe tatimet në pajtim me legjislacionin e Administratës Tatimore të Kosovës.
7. Parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë dëshmi nga Gjykata Ekonomike që nuk ka kontest gjyqësor.

NENI 17 **KRITERET PROGRAMORE**

Kriter i përgjithshëm programor për ofrues të shërbimit medial audio dhe audiovizual përmes operatorëve të shpërndarjes është pajtueshmëria e skemës programore javore, përfshirë segmentet dhe strukturën programore, me aktet nënligjore të KPM-së.

NENI 18 **KRITERET EKONOMIKE**

Kriteret ekonomike për ofrues të shërbimit medial audio dhe audiovizual përfshijnë:

1. Qëndrueshmërinë ekonomike të parashtruesit të kërkesës për sa i përket sasisë së kapitalit të përbashkët të regjistruar.
2. Performancën ekonomike të parashtruesit të kërkesës për sa i përket strukturës dhe burimeve të financimit, përfshirë masat e likuiditetit, aftësinë paguese dhe borxhit.
3. Plani i biznesit për tri vitet e ardhshme, përfshirë strukturën organizative dhe numrin e përgjithshëm të të punësuarve.

NENI 19 **DHËNIA E LICENCËS**

Licenca për OSHM përmes operatorëve të shpërndarjes jepet pa konkurs publik sipas procedurave të përcaktuara të KPM-së.

KREU IV
LICENCIMI I OFRUESIT TË SHËRBIMIT MEDIAL ME KËRKESË
(ON-DEMAND)

NENI 20
PARASHTRIMI I KËRKESËS PËR LICENCË

1. Kërkesa për licencë të KPM-së për ofrues të shërbimit medial me kërkesë, mund të parashtrohet në çdo kohë dhe pa konkurs, sipas procedurave të përcaktuara nga KPM.
2. Licenca për OSHM me kërkesë (on-demand), jepet në baza jo-ekskluzive.
3. Kërkesa për licencë për OSHM me kërkesë (on-demand) mund të bëhet nga çdo person fizik apo juridik i regjistruar në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit të aplikueshëm.
4. Kërkesa për licencë duhet të dorëzohet në Formularin e përcaktuar nga KPM-ja sipas udhëzimeve të përcaktuara në Formular.
5. OSHM me kërkesë (on-demand) duhet të informojë KPM-në lidhur me orientimin programor, si dhe katalogun në dispozicion të përmbajtjes programore.
6. Kërkesa për licencë do të konsiderohet e kompletuar vetëm nëse Formulari është e plotësuar në mënyrë të duhur dhe në tërësi, së bashku me dokumentacionin përcjellës të përcaktuar sipas Formularit. Kërkesa për licencë mund të refuzohet vetëm nëse kandidati ka ofruar informata të pavërteta.
7. OSHM me kërkesë do të jetë përgjegjës për përmbajtjen e tij programore, pavarësisht origjinës së tyre, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
8. OSHM me kërkesë duhet të promovojë prodhimet e veprave kosovare dhe evropiane varësisht prej mundësive financiare.
9. OSHM me kërkesë duhet të përpiqet që shërbimet e tij të jenë të qasshme për personat që kanë vështirësi në shikim dhe dëgjim.
10. OSHM me kërkesë duhet të identifikohet në katalogun e tij programor.

KREU V

OBLIGIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMIT MEDIAL

NENI 21

PËRGJEGJËSITË

1. OSHM është përgjegjës për natyrën dhe përmbajtjen e programeve të transmetuara dhe është përgjegjës për çdo dëmtim që mund t'i shkaktojë palës së tretë në pajtim me ligjet e aplikueshme.
2. OSHM është e obliguar të veprojë në pajtueshmëri me standardet lidhur me transmetimin dhe prodhimin e kuotave programore të përcaktuara nga KPM-ja.
3. OSHM obligohet të ofrojë përshkrim për masat teknike të parapara për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve.
4. OSHM do të ofrojë masa teknike dhe përmbajtjesore të favorshme për personat me vështirësi në dëgjim dhe të pamur lidhur me programet informative, kulturore dhe zbavitëse. Në të njëjtën kohë OSHM duhet të ofrojë një përshkrim lidhur me këto masa të parapara.
5. OSHM-ja është e obliguar të veprojë në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së, aktet nënligjore të KPM-së dhe legjislacion tjetër përkatës në Republikën e Kosovës.
6. OSHM është e obliguar të ruajë dhe mirëmbajë arkivin e programeve të transmetuara për një kohë prej 21 ditësh dhe kur është e nevojshme t'ia ofrojë atë KPM-së për aktivitete të monitorimit.
7. I Licencuari duhet ta identifikojë përmbajtjen e tij me anë të logos, e cila mund të ndryshohet vetëm me miratim paraprak nga KPM-ja.
8. I Licencuari duhet të jetë përgjegjës për tërë përmbajtjen programore pavarësisht origjinës dhe duhet të sigurojë që përmbajtjet programore të jenë në pajtueshmëri me ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së.
9. Së paku 20% e programit javor të të Licencuarit duhet të jetë program vetanak, dhe së paku 75 minuta të atij programi duhet të transmetohet në mes orës 17:00 deri në 24:00.
10. Paragrafi 8 nuk do të aplikohet për kanalet tematike, përfshirë kanalet që ekskluzivisht i dedikohen teleshoppingut apo vet-promovimit.
11. I Licencuari mund të ritransmetojë programe të cilat nuk i kalojnë 20% të programit të përgjithshëm ditor. Burimi i programit të ritransmetuar duhet të identifikohet qartë dhe në

vazhdimësi. Çdo ritransmetim duhet të bazohet në një kontratë me shkrim në mes të të Licencuarit dhe ofruesit të shërbimit medial, programi i të cilit ritransmetohet.

12. Dy apo më shumë të Licencuar mund të shkëmbejnë segmente programore të prodhimit vetanë në bazë të marrëveshjeve me shkrim.
13. I Licencuari duhet të përpiqet të ofrojë qasje për shërbimet e tij për persona me nevojë të veçanta (me vështirësi në dëgjim/shikim).

KREU VI

VEPRAT AUDIOVIZUALE TË OFRUESIT TË SHËRBIMIT MEDIAL

NENI 22 VEPRAT KOSOVARE

1. Për qëllim të kësaj Rregulloreje, veprat kosovare nënkuptojnë:
 - 1.1 veprat me origjinë nga Republika e Kosovës; dhe
 - 1.2 veprat që janë prodhuar në gjuhët e komuniteteve në Republikën e Kosovës, si dhe veprat që kanë të bëjnë me trashëgiminë kulturore.
2. Veprat e referuara në paragrafin 1 të këtij Neni janë vepra që kryesisht janë krijuar nga autorë rezident në Republikën e Kosovës dhe që përmbushin kriteret e mëposhtme:
 - 2.1 janë të krijuara nga një apo më shumë producentë të regjistruar në Republikën e Kosovës; dhe
 - 2.2 prodhimi i një vepre individuale mbikëqyret apo kontrollohet nga një apo më shumë producentë të regjistruar në Republikën e Kosovës apo kontributi i bashkëprodhuesve nga Republika e Kosovës në koston e përgjithshme të bashkëprodhimit është dominues dhe bashkëprodhimi nuk kontrollohet nga një apo më shumë prodhues të themeluar jashtë vendit.
3. I Licencuari duhet të rezervojë së paku 20% të përmbajtjes programore për veprat kosovare në bazë javore, duke përjashtuar kohën e caktuar për lajme, ngjarje sportive, lojëra, reklamim, shërbime të teletekstit dhe teleshoppingut. Kjo përqindje duhet të arrihet në mënyrë progresive brenda pesë (5) vitesh pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.
4. Dispozita e paragrafit 3 nuk do të aplikohen për të Licencuarit me mbulim lokal/regjional si dhe kanalet tematike, përfshirë ato të dedikuara për teleshopping dhe vet-promovim.

NENI 23 VEPRAT EVROPIANE

1. Për qëllim të kësaj Rregulloreje, veprat evropiane nënkuptojnë:
 - 1.1 Veprat me origjinë nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian;
 - 1.2 Veprat me origjinë nga shtetet tjera evropiane, anëtarë të Konventës Evropiane mbi Televizionet Pakufi të Këshillit të Evropës;
 - 1.3 Veprat e bashkëprodhuara brenda kornizës së marrëveshjeve që kanë të bëjnë me sektorin audiovizual të arritur në mes të Shteteve Anëtare të BE-së dhe shteteve tjera evropiane dhe që përmbushin kushtet e definuara në secilën prej këtyre marrëveshjeve.
 - 1.4 Veprat evropiane përfshijnë edhe veprat e prodhuara në Republikën e Kosovës si dhe prodhimet vetanake të të Licencuarit, duke përfshirë lajmet, ngjarjet sportive, lojëra, reklamat, shërbimet e teletekstit dhe teleshopingun.
2. I Licencuari duhet që, në mënyrë të përshtatshme, të rezervojë së paku 10% të përmbajtjes programore për vepra evropiane të krijuara nga prodhues të pavarur, duke përfshirë lajmet, ngjarjet sportive, lojëra, reklamat, shërbimet e teletekstit dhe teleshopingun. Kjo përqindje duhet të arrihet në mënyrë progresive brenda pesë (5) viteve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.
3. Dispozita e paragrafit 2 nuk do të aplikohen për të Licencuarit me mbulim lokal/regjional si dhe kanalet tematike, përfshirë ato të dedikuara për teleshoping dhe vet-promovim.

KREU VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

NENI 24 TRANSFERIMI I LICENCËS

Licencat nuk mund të shfrytëzohen dhe barten pa autorizimin dhe pa aprovimin paraprak me shkrim të KPM-së.

NENI 25 TARIFA PËR LICENCË

I Licencuari obligohet të bëjë pagesën vjetore të tarifës së licencës në pajtim me Ligjin e KPM-së.

NENI 26
KONCENTRIMI I PRONËSISË NË MEDIA

Koncentrimi i pronësisë në media në Republikën e Kosovës do të rregullohet nga KPM-ja me një akt të veçantë nënligjor.

NENI 27
SANKSIONET

Dështimi për të vepruar në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje do të rezultojë në ndërmarrjen e masave sanksionuese nga KPM në bazë të Ligjit të KPM-së.

NENI 28
HYRJA NË FUQI

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



25.01.2017
Data: